



Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 289 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01

Data/Darum/Date 30 03 2022

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.03.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës

1. **Miratohet** vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 2.1. Nora Boshnjaku – Drejtoresh e Isneptoriatit - AAK;
 - 2.2. Saranda Sallteku - Drejtoresh e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale - AAK;
 - 2.3. Dorentina Sopjani, anëtare nga Kuvendi i Komunës - AAK;
 - 2.4. Armir Vuçetërma, anëtar nga Kuvendi i Komunës - PDK;
 - 2.5. Nazim Bellaqa, anëtar nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për shqyrtimin e ankesave janë: shqyrtimi i ankesave që paraqiten nga palët e pakënaqura ofertuese pas procesit të vlerësimit final të ofertave, të përzgjedhura të përzgjedhura nga ana e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës dhe atë:
 - 3.1. Refuzimin e ankesës dhe lënien në fuqi të procesit të vlerësimit final të ofertave;
 - 3.2. Miratimin e ankesës dhe shfuqizimin (revokimin) e procesit të vlerësimit final të ofertave.
4. Mandati i komisionit për shqyrtimin e ankesave është 2 (dy) vjeçar.
5. Kuvendi i Komunës e ruan të drejtën e ndryshimit dhe plotësimit të këtij vendimi kurdoherë që e sheh të arsyeshme.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËSNËRAHOVEC

01 Nr.289/22
Datë:30.03.2022

